



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 119

Tiranë – E mërkurë, 7 shtator 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 18, datë 24.8.2022	Mbi garancinë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për veprimtaritë minerare..... 15795
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 19, datë 24.8.2022	Për miratimin e formatit standard për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit në veprimtaritë minerare..... 15797
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 207, datë 17.8.2022	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2022..... 15805
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 208, datë 17.8.2022	Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 70, datë 11.4.2022, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 489, seria P21, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k.”, dhe rishikimin e vendimit nr. 99, datë 16.4.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Vardari’, me kapacitet të instaluar 1972 kw”..... 15806
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 209, datë 17.8.2022	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”..... 15808
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 210, datë 17.8.2022	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 168, datë 28.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”..... 15809
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 211, datë 17.8.2022	Mbi shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike..... 15810

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 212, datë 17.8.2022	Mbi heqjen e licencës nr. 380, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 6.9.2017.....	15811
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimet nr. 51/6, datë 1.9.2022	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Zgjerimi i varrezave publike Kuçovë”.....	15813
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimet nr. 90/6, datë 1.9.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor ‘Sistemim-asfaltim rruga Korçë–Ersekë, loti 1’”.....	15815
	Për shpalljen të vdekur të shtetasës Arsino Mersini.....	15819

**UDHËZIM I PËRBASHKËT****Nr. 18, datë 24.8.2022****MBI GARANCINË FINANCIARE PËR
REALIZIMIN E PLANIT TË
REHABILITIMIT TË MJEDISIT PËR
VEPRIMTARITË MINERARE**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 11, të kreut i, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 741, datë 9.9.2015, “Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjeve të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e planit minimal të punës dhe realizimit të investimit në veprimtarinë minerare”, të ndryshuar, ministri përgjegjës për veprimtaritë minerare dhe ministri përgjegjës për mjedisin

UDHËZOJNË:**I. GARANCIA FINANCIARE PËR REALIZIMIN E PLANIT TË REHABILITIMIT TË MJEDISIT PËR LEJET E KËRKIM-ZBULIMIT**

1. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), në cilësinë e strukturës përgjegjëse për lejet e kërkim-zbulimit, vlerëson planin e rehabilitimit përfundimtar dhe progresiv të mjedisit dhe përcakton vlerën monetare të garancisë financiare të detyrueshme, të përgjithshme e vjetore, për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, duke marrë në konsideratë parashikimet e pikës 1, të VKM-së nr. 741, datë 9.9.2015, “Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjeve të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e planit minimal të punës dhe realizimit të investimit në veprimtarinë minerare”, të ndryshuar. Kjo vlerë përcaktohet në vendimin e Këshillit Teknik të SHGJSH-së dhe miratohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare.

2. Zotëuesi i lejes minerare dorëzon në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), garancinë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për vitin e parë, jo më vonë se 30 ditë nga data e njoftimit të vendimit të miratimit të lejes minerare. Për vitin e dytë dhe në vazhdim, dokumenti i garancisë financiare vjetore depozitohet në SHGJSH dhe në

ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas përfundimit të vitit paraardhës, i cili përlllogaritet duke filluar nga data efektive e marrjes së lejes minerare.

3. SHGJSH-ja, pas rivlerësimit të vlerës së garancisë për realizimin e planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të mjedisit të lejeve minerare, për lejet e kërkim-zbulimit, për vitin e dytë e në vazhdim, i përcjellë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) një kopje të dokumentit të garancisë financiare vjetore të përlllogaritur.

4. Vlera e garancisë financiare i kthehet zotëruesit të saj pas përfundimit të procesit të rehabilitimit të mjedisit për lejet e kërkim-zbulimit dhe miratimit të raportit përkatës mbi realizimin e planit.

5. Për të vlerësuar realizimin/përfundimin e rehabilitimit mjedisor, sipas planit të rehabilitimit nga zotëruesi i lejes minerare, kryhet verifikimi dhe kontrolli në terren i zbatimit të planit të rehabilitimit.

6. Verifikimi dhe kontrolli kryhet nga një grup pune i përbashkët, i ngritur me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe ministrit përgjegjës për veprimtaritë minerare. Grupi i punës ka në përbërje 3(tre) anëtarë nga SHGJSH-ja dhe 2 (dy) anëtarë nga AKM-ja.

7. Pas verifikimit dhe kontrollit në terren, grupi i punës harton dhe dorëzon në SHGJSH raportin mbi realizimin e planit të rehabilitimit.

8. Këshilli Teknik i SHGJSH-së vlerëson raportin e grupit të punës dhe, së bashku me vendimin e tij, ia përcjell për miratim ministrit përgjegjës për veprimtaritë minerare dhe ministrit përgjegjës për mjedisin, të cilët e miratojnë ose jo brenda 15 ditëve.

9. Drejtoria kompetente në ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, brenda 10 ditëve nga data e miratimit të raportit nga ministrat përgjegjës, harton urdhrin për kthimin ose jo të garancisë financiare bazuar në raportin e miratuar.



II. GARANCIA FINANCIARE PËR REHABILITIMIN E MJEDISIT PËR LEJET E SHFRYTËZIMIT DHE LEJET E KËRKIM-ZBULIM-SHFRYTËZIMIT

1. Agjencia Kombëtare e Burime Natyrore (AKBN), në cilësinë e strukturës përgjegjëse për lejet e shfrytëzimit dhe lejet e kërkim-zbulim-shfrytëzimit, vlerëson planin e rehabilitimit përfundimtar dhe progresiv të mjedisit dhe përcakton vlerën monetare të garancisë financiare të detyrueshme, të përgjithshme e vjetore, për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, duke marrë në konsideratë parashikimet e pikës 1, të VKM-së nr. 741/2015. Kjo vlerë përcaktohet në vendimin e Këshillit Teknik të AKBN-së dhe miratohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare.

2. Zotëruesi i lejes minerare dorëzon në QKB garancinë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për vitin e parë, jo më vonë se 30 ditë nga data e njoftimit të vendimit të miratimit të lejes minerare. Për vitin e dytë dhe në vazhdim, dokumenti i garancisë financiare vjetore depozitohet në AKBN, në AKM dhe në ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas përfundimit të vitit paraardhës, i cili përllogaritet duke filluar nga data efektive e marrjes së lejes minerare.

3. AKBN-ja, pas rivlerësimit të vlerës së garancisë për realizimin e planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të mjedisit të lejeve minerare, për lejet e shfrytëzimit dhe lejet e kërkim-zbulim-shfrytëzimit, për vitin e dytë e në vazhdim, i përcjell AKM-së një kopje të dokumentit të garancisë financiare vjetore të përllogaritur.

4. Vlera e garancisë financiare i kthehet zotëruesit të saj pas përfundimit të procesit të rehabilitimit të mjedisit për lejet e shfrytëzimit dhe lejet e kërkim-zbulim-shfrytëzimit.

5. Për të vlerësuar realizimin/përfundimin e rehabilitimit mjedisor sipas planit të rehabilitimit nga zotëruesi i lejes minerare, kryhet verifikimi dhe kontrolli në terren i zbatimit të planit të rehabilitimit.

6. Verifikimi dhe kontrolli kryhet nga një grup pune i përbashkët, i ngritur me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe ministrit përgjegjës për veprimtaritë

minerare. Grupi i punës ka në përbërje 3 (tre) anëtarë nga AKBN-ja dhe 2 (dy) anëtarë nga AKM-ja.

7. Pas verifikimit dhe kontrollit në terren, grupi i punës harton dhe dorëzon në AKBN raportin mbi realizimin e planit të rehabilitimit.

8. Këshilli Teknik i AKBN-së vlerëson raportin e grupit të punës dhe, së bashku me vendimin e tij, ia përcjell për miratim ministrit përgjegjës për veprimtaritë minerare dhe ministrit përgjegjës për mjedisin.

9. Drejtoria përkatëse në ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, brenda 10 ditëve nga data e miratimit të raportit nga ministrat përgjegjës, harton urdhrin për kthimin ose jo të garancisë financiare bazuar në raportin e miratuar.

III. REHABILITIMI I MJEDISIT KUR GARANCIA KALON NË FAVOR TË SHTETIT

1. Në rastet e parashikuara në pikat 12 dhe 13 të kreut 1, të VKM-së nr. 741, datë 9.9.2015, të ndryshuar, kur vlera e plotë e garancisë vjetore apo e përgjithshme për rehabilitimin e mjedisit kalon në favor të shtetit, kjo vlerë do të përdoret për rehabilitimin progresiv ose përfundimtar të mjedisit në zonën përkatëse ose, në raste të veçanta, në zonën përreth, pas miratimit me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për veprimtaritë minerare dhe ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

2. Ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare, referuar ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, zbaton procedurat standarde të prokurimit për përzgjedhjen e subjektit, i cili do të realizojë rehabilitimin e zonës përkatëse apo të zonës përreth të përcaktuar për t’u rehabilituar.

3. Për zbatimin e pikës 2, të kreut III, të këtij udhëzimi, ministri përgjegjës për veprimtaritë minerare dhe ministri përgjegjës për mjedisin ngrenë me urdhër të përbashkët grupin e punës, i cili do të hartojë specifikimet teknike për zhvillimin e procedurës së prokurimit nga ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare.

4. Grupi i punës ka në përbërje 3 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare dhe 2 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mjedisin.



5. Pas fazës së lidhjes së kontratës sipas pikës 2, të kreut III, të këtij udhëzimi, ministria përgjegjëse për veprimtaritë minerare dhe ministria përgjegjëse për mjedisin ngrenë një grup të përbashkët pune, i cili do të kryejë supervizimin dhe kolaudimin e projektit të rehabilitimit e zonës përkatëse apo zonës përreth, të përcaktuar në zbatim specifikimeve të hartuara, sipas pikës 3, të kreut III, të këtij udhëzimi.

6. Grupi i punës ka në përbërje tre (3) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare dhe dy (2) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mjedisin.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
Belinda Balluku

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

UDHËZIM I PËRBASHKËT **Nr. 19, datë 24.8.2022**

PËR MIRATIMIN E FORMATIT STANDARD PËR HARTIMIN E PLANIT TË REHABILITIMIT TË MJEDISIT NË VEPRIMTARITË MINERARE

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; pikës 5, të kreut I, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 741, datë 9.9.2015, “Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjeve të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e planit minimal të punës dhe realizimit të investimit në veprimtarinë minerare”, të ndryshuar, ministri përgjegjës për veprimtaritë minerare dhe ministri përgjegjës për mjedisin

UDHËZOJNË:

1. Subjektet që kërkojnë të pajisen me leje për zhvillimin e veprimtarisë minerare apo që zhvillojnë veprimtari minerare, hartojnë planin e

rehabilitimit, sipas formatit standard të përcaktuar në aneksin 1 (një) bashkëlidhur që është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Plani i rehabilitimit të mjedisit, i hartuar sipas formatit standard të parashikuara në pikën 1 të këtij udhëzimi, depozitohet nga subjektet në momentin e aplikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për leje minerare dhe leje mjedisore, dhe vlerësohet gjatë këtij procesi nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe/apo, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH).

3. Plani i rehabilitimit të mjedisit ka synim:

a) të arrijë një stabilizim të zonave të dëmtuara nëpërmjet ndërhyrjeve inxhinierike për të minimizuar ndër të tjera erozionin;

b) të rigjëlborojë zonën në të cilën bëhet rehabilitimi me bimësi të përshtatshme, që kanë ekzistuar më parë;

c) të minimizojë ndikimin pamor të zonave të degraduara e të përmirësojë peizazhin.

4. Rehabilitimi i sipërfaqeve që do të shfrytëzohen apo të shfrytëzuara nga veprimtaritë minerare është pjesë e pandarë e veprimtarisë së tyre. Rehabilitimi i sipërfaqeve të dëmtuara parashikohet, planëzohet dhe zhvillohet njëkohësisht me veprimtarinë shfrytëzuese dhe vazhdon edhe pas përfundimit të kësaj veprimtarie, derisa sipërfaqja që është shfrytëzuar nga kjo veprimtari, të jetë rehabilituar plotësisht.

5. Subjektet minerare kanë detyrimin të raportojnë çdo gjashtë muaj në SHGJSH/AKBN (sipas llojit të lejes minerare) dhe në AKM, mbi ecurinë e rehabilitimit mjedisor progresiv dhe të menaxhimit të mbetjeve të dala nga veprimtaritë minerare, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

MINISTËR I TURIZMIT
DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi



Format Standart i Planit të Rehabilitimit të Mjedisit për Veprimtaritë Minerare

Qarku _____
Bashkia _____
Njësia e Qeverisjes Vendore _____

PLAN REHABILITIMI

PROJEKTUESI

Ing. _____

MIRATOI

STRUKTURA PËRGJEGJËSE

VITI.....



KAPITULLI I PUNIME REHABILITUESE NËPËRMJET PYLLËZIMIT

SEKSIONI I	
Të dhëna të përgjithshme për subjektin që do të kryejë punimet rehabilituese	
Emri i subjektit	
NUIS	
Historik i shkurtër i veprimtarisë së subjektit	
Vendburimi i zonës ku do të ushtrojë veprimtarinë minerare	
Përshkrimi i veprimtarisë që zhvillon subjekti	
Leja mjedisore me nr. PN ose LC	
SEKSIONI II	
Të dhëna të përgjithshme të sipërfaqes që do të rehabilitohet	
Bashkia	
NJQV/Fshati	
Zona kadastrale	
Sipërfaqja totale e lejes minerare	
Sipërfaqja në ha që do të rehabilitohet (<i>pyllëzohet</i>)	
Koordinatat e zonës që do të rehabilitohet	
Afati kohor i kryerjes së rehabilitimit	
Të specifikohet sipërfaqja e pjesshme që do të rehabilitohet për ata operatorë që janë akoma në proces shfrytëzimi.	
SEKSIONI III	
Qëllimi i rehabilitimit të sipërfaqes (<i>bëhet përshkrimi i shkurtër i qëllimit të rehabilitimit</i>)	
SEKSIONI IV	
Karakteristikat stacionale të sipërfaqes që do të rehabilitohet sipas planëzimit	
Gjendja ekzistuese e sipërfaqes që do të rehabilitohet	<i>Bëhet përshkrimi i gjendjes ekzistuese</i>
Pozicioni i objektit	<i>Bëhet një përshkrim i sipërfaqes referuar relievit</i>
Përdorimi i deritanishëm	
Klima	<i>Përshkruben indikatorët kryesorë të klimës</i>
Toka	
Orografia	
Kundrejtimi	
Pjerrësia	
Lartësia mbi nivelin e detit	
Mbulesa bimore	
SEKSION V	
Zbatimi i punimeve në sipërfaqen që do të rehabilitohet	
Lloji i punimeve	
Puna përgatitore	<i>Do të bëhet një përshkrim i punëve përgatitore deri në nisjen e procesit të rehabilitimit p.sh. pastrimi i shkurreve ferrave etj.</i>
Koha e mbjelljes	
Përqindja e zënies së objektit pas vitit të parë	
Lloji i fidanit	
Skema e mbjelljes	
Numri i fidanëve sipas llojeve për hektar dhe ngastër	
Materiali mbjellës që do të përdoret	<i>Të përcaktohen standardet e materialit mbjellës bimor, në zbatim ligji nr. 8732, datë 24.1.2001, "Për materialin mbjellës bimor"</i>
Zgjedhja e metodës, skemave dhe formulave të pyllëzimit	
Shërbimet kulturele që do të kryhen	
Zëvendësimet	<i>Lloji i bimësisë i njëjtë me atë që do të mbillet</i>
Buxheti i planifikuar	<i>Përmban buxhetin e pyllëzimit, shërbimeve dhe zëvendësimeve dhe ruajtjen e objektit</i>
Koha kur do të kryhet verifikimi i zënies	

VI. HARTA DHE PLANIMETRIA E ZONËS QË DO TË REHABILITOHEJ, SKEMA DHE VENDET E MBJELLJES (*hartë topografike ku të dallohen qartë orografia, rrjeti hidrik, rrjeti rrugor, vendosja skematike e vendmbjelljeve në hartë, sipas skemës*)

VII. FOTOT E SIPËRFAQES QË DO TË REHABILITOHEJ

VIII. PREVENTIVAT E PUNIMEVE REHABILITUESE (*bashkëngjitur në lidhjen 1*)

**LIDHJA 1**

P R E V E N T I (tip)
P Ë R
PYLLËZIME ME LLOJIN
SKEMA.....x,,,,,,,,,
Për 1 Ha

Emri i objektit _____
Sipërfaqja _____ *ha*
Nr.i parcelës/nënparselës _____

Nr. rendor	Shenja e manualit	Përshkrimi i punimeve	Njësia e matjes	Volumi i punës	Norma ditore	Ditë pune	Paga për ditë pune	Shuma lekë
Shuma								

Preventivuesi

Ing. _____



PREVENTIV
PËR ZEVENDEËSIME ME LLOJIN

Për 1 Ha

Shenja e normes	Pershkrimi i punes	Njesia e matjes	Volumi i punes	Norma	Dite pune	Paga/D.p	Vlera/lek

Preventivuesi

Ing. _____

PREVENTIV PER SHERBIME KULTURALE

Për 1 ha

Shenja e normes	Pershkrimi i punes	Njesia e matjes	Volumi i punes	Norma	Dite pune	Paga/D.p	Vlera/lek

Preventivuesi

Ing. _____



KAPITULLI II

PUNIME REHABILITUESE NËPËRMJET SISTEMIMIT TË ZONËS MINERARE TË SHFRYTËZUAR

ZBATIMI I PUNIMEVE	
Çmontim dhe largim i teknologjisë së prodhimit/kërkimit (fadroma, eskavatorë etj.), duke evituar dëmtimet në mjedis, si rrjedhja e lëndës djegëse ose e vajrave të makinave	
Sistemimi i zonës në të cilën ka përfunduar shfrytëzimi/kërkimi	<i>Plan-rehabilitimi duhet të realizohet edhe në rastet kur nuk del mineral nga kërkimi (pasi rezultojnë se operatorët nuk e kryejnë rehabilitimin e sipërfaqes së ndikuar)</i>
Punimet gjeologjike	
Punimet biologjike	Trajtimi biologjik (zakonisht i aplikuar në kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe të gazit) Metodat e trajtimit biologjik ndonjëherë përdoren në kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe të gazit, për shkak të përmbajtjes së lartë të lëndës organike në mbetjet nxjerrëse. Në përgjithësi zbatohet biodegradimi i lëndës organike nga mikroorganizmat. Bujqësia e tokës, trajtimi i tokës dhe kompostimi janë tri metodat kryesore të trajtimit biologjik. Kompostimi konsiston në përzierjen e mbetjeve nxjerrëse, me: - agjentët zmadhues, si copat e drurit, kashta ose lëvozhga e orizit për të rritur porozitetin dhe për të siguruar kushte aerobike; - pleh organik për të siguruar lëndë ushqyese; - plehra (që përmbajnë veçanërisht azot dhe fosfor) për të rritur aktivitetin mikrobik. Kompostimi kryhet në pirlë. Trajtimi i tokës zakonisht kryhet në objekte të ngjashme me ato bujqësore. Ai përfshin përhapjen e tokës dhe biotrajtimin. Dallimi kryesor midis bujqësisë së tokës dhe trajtimit të tokës është frekuenca e depozitimit. Bujqësia e tokës i referohet përhapjes periodike të mbetjeve në sipërfaqen e tokës, ndërsa trajtimi i tokës i referohet një depozitimi të vetëm të mbetjeve nxjerrëse. Prandaj, trajtimi i tokës, rreziku i akumulimit të elementeve jo të biodegradueshme është më i ulët në trajtimin e tokës se sa në bujqësinë e tokës.
Mënyra e piktimit	
Përgatitja e tokës në kushte optimale për zhvillimin e vegjetacionit	
Sistemimi i masës së dheut dhe stabilizimi fizik në shkallët mbrojtëse të dheut dhe plehërimi organik i masës së dheut	Land farming (ritje Rritje e prodhimtarisë së tokës, Rritja e pjellorisë së tokës kryhet në objekte ku mbetjet depozitohen në shtresa në një tokë. Mikroorganizmat e pranishëm në tokë degradojnë hidrokarburet që gjenden në mbetje. Objekti punohet periodikisht për të siguruar oksigjen dhe për të përzier dheun. Uji dhe lëndët ushqyese mund të shtohen për të përmirësuar procesin e degradimit. Degradimi zakonisht kryhet në kushte aerobike. Metoda e kultivimit të tokës është e kufizuar nga akumulimi i materialeve jo të biodegradueshme në tokë si metalet dhe hidrokarburet poliaromatike. Mbetja e prodhuar e trajtuar mund të përdoret për ndërtimin e rrugëve, për shembull.
Punime inxhinierike	(Hapjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve automobilistike për hyrjen në sheshin e punës, hapjen e kanaleve për drenazhimin dhe disiplinimin e ujërave.)
Të mundësojë në fazat e mëvonshme të maturimit të procesit të rehabilitimit përdorimin e sipërfaqes	



Sistemimin e skarpateve përfundimtare të shkallëve të shfrytëzimit, duke respektuar parametrat gjeomekanikë dhe gjeometrikë të tyre	
Lënie e brezave mbrojtës midis kufijve të zonës së shfrytëzimit dhe sipërfaqes tjetër (jashtë kufirit të zonës)	
Sistemimin, përpunimin dhe mbulimin e sipërfaqeve horizontale të shkallëve, duke i kthyer ato në formë brezaresh	
Krijimin e kushteve të përshtatshme për mbjelljen dhe kultivimin e bimëve dhe të pemëve të ndryshme lokale	
Distanca e sigurisë nga kufijtë në minierë Lartësia përfundimtare e shkallëve të shfrytëzuara, numri i shkallëve, pjerrësia e skarpateve dhe këndi i shuarjes së punimeve	
Mënyra e shfrytëzimit të objektit mineral dhe variantet e hapjes	
Mbjellja e tarracave sipas habitateve	
Gjendja e objektit në fund të shfrytëzimit	
Ndikimi i shfrytëzimit në sipërfaqe	
Masat e sigurimit teknik gjatë fazës së çmontimit, për krehjen e shpateve, sistemimit të stoqeve dhe përfundimi i mureve mbajtës të stoqeve	

KAPITULLI III

PLANI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE MINERARE

TË DHËNA QË LIDHEN ME PLANIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE MINERARE	PARAMETRAT E NEVOJSHËM
Informacion administrativ	Emri i kompanisë
	Koordinatat e vendndodhjes
	Emri i menaxherit të kantierit/të dhënat e kontaktit
	Administratori i shoqërisë zotëruese të lejes minerare/të dhënat e kontaktit
	Të dhënat e kontaktit në rast emergjence
	Data
Përshkrimi gjeologjik i vendburimit mineral	Lloji i shkëmbit dhe përshkrimi mineralogjik i burimit mineral që do të përdoret
Përshkrimi i llojeve të materialeve	Përmasat e vendburimit mineral
Mbetje të gjeneruara nga procese individuale	Lista e çdo lloji materiali, përfshirë sasinë dhe destinacionin
	Gërmim
	Thërrmim dhe bluarje
	Ndarje magnetike ose procese të tjera ndarje
Karakteristika mineralogjike dhe gjeokimike	Procese të tjera
	Lloji i shkëmbit
	Përbërja kimike
	Kodi i mbetjeve sipas katalogut shqiptar të mbetjeve
Karakteristika gjeoteknike	Densiteti
	Poroziteti
	Përshkueshmëria
	Përbërja mineralogjike
	Përmbajtja e ujit
	Indekset e plasticitetit
	Shkalla e ngjeshjes
	Qëndrueshmëria në shtypje
Klasifikimi i mbetjeve (sipas direktivës 2009/539/EC, 2009/360/EC dhe 2014/955/EU)	Mbetje e rrezikshme/mbetje jo e rrezikshme dhe jo inerte/mbetje inerte
Kategoria e impiantit të mbetjeve minerare, për impiantet e seleksionimit, fabrikat e pasurimit dhe uzinat e ferrokromit	Kategoria A/jo kategoria A (sipas direktivës 2009/337/EC)



Struktura e impiantit, për impiantet e seleksionimit, fabrikat e pasurimit dhe uzinat e ferrokromit	Detajet e projektimit dhe të konstruksionit të impiantit të mbetjeve minerare
Menaxhimi i materialit të gërmuar	Materiali i gërmuar (sasia në funksion të kohës)
	Sasia dhe lloji i materialit të gërmuar i përdorur për qëllime ndërtimi në minierë (në funksion të kohës)
	Sasia dhe lloji i materialit të gërmuar i përdorur për mbushje të gropave të minierës për qëllime inxhinierike ose për qëllime rikuperimi (në funksion të kohës)
	Sasia e mbetjeve jominerare dhe mënyrat e menaxhimit të tyre (në funksion të kohës)
Menaxhimi i mbetjeve minerare	Sasia e mbetjeve minerare të depozituar (në funksion të kohës)
	Sasia e planifikuar për depozitim e mbetjeve minerare (në funksion të kohës)
	Sasia totale e mbetjeve minerare për t'u depozituar gjatë ciklit jetësor
	Sasia e mbetjeve minerare e rikuperuar dhe e ripërdorur (në funksion të kohës)
Vlerësimi i rrezikut	Përmbledhje e vlerësimit të rrezikut e kryer me VNM paraprake, çdo përditësim apo specifikim tjetër për planin e menaxhimit të mbetjeve minerare
	Kushtet specifike që kontribuojnë për rrezikun: - kushtet klimatike (p.sh.: intensiteti dhe frekuenca e rënies së shiut), si nxitës për migrimin e ndotësve - përshkrimi i ndodhive natyrore të mundshme (p.sh.: tërmete, vullkane)
	Masa për eliminimin ose reduktimin e rrezikut
Planet e emergjencës (detajim i veprimeve dhe i personave përgjegjës)	Planet e emergjencës për kategorinë A të impianteve të mbetjeve minerare
	Planet e emergjencës për impiante të tjera të mbetjeve minerare
Planet e mbylljes	Planet provizore (për t'u përditësuar periodikisht së bashku me planin e menaxhimit të mbetjeve minerare)
	Dispozitat financiare për të siguruar mbylljen e rregullt
Planet e menaxhimit afatgjatë	Planet fillestare për paspërdorimit të minierave dhe impianteve për impiantet e seleksionimit, fabrikat e pasurimit dhe uzinat e ferrokromit, të mbetjeve minerare (për t'u përditësuar periodikisht së bashku me planin e menaxhimit të mbetjeve minerare)

Plani menaxhimit të mbetjeve minerare, duhet të shpjegojë se si do të menaxhoni mbetjet minerare, duke përfshirë:

- Si i klasifikoni zonat dhe objektet e mbetjeve minerare në vendin tuaj?

- Zona ose vendndodhja e mbetjeve minerare, impianti i mbetjeve minerare ose objekti i kategorisë A.

- Si i karakterizoni mbetjet tuaja minerare:

- inerte;

- jo të rrezikshme joinerte;

- e rrezikshme.

- Si krijoni dhe trajtoni mbetjet minerare:

- Si dhe ku krijoni, ruani, trajtoni dhe transportoni mbetjet minerare?

- Sa mbetje minerare gjeneroni?

- Ku do të përfundojnë mbetjet tuaja minerare?

- Si mund të ndikojnë mbetjet tuaja minerare në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, duke përfshirë kryerjen e një vlerësimi të rrezikut mjedisor?

- Si do të minimizoni ndikimet mjedisore gjatë jetës së minierës ose gurores suaj, duke përfshirë atë që do të bëni kur ndërtoni një impiant të ri mbetjesh minerare ose ndryshoni një impiant ekzistues të mbetjeve minerare?

- Nëse keni ndërmend të vendosni mbetje minerare në zbrazëtirat e gërmimit, si propozoni të kontrolloni dhe të monitoroni qëndrueshmërinë e mbetjeve nxjerrëse dhe të parandaloni ndotjen e tokës ose të ujit?

- Si kontrolloni dhe monitoroni mbetjet tuaja minerare?



- Planet tuaja për mbylljen e çdo impianti të mbetjeve minerare, për impiantet e seleksionimit, fabrikat e pasurimit dhe uzinat e ferrokromit, duke përfshirë rehabilitimin, kujdesin pasues dhe monitorimin e ndikimeve mjedisore.

VENDIM

Nr. 207, datë 17.8.2022

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN KORRIK 2022

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.8.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1458 prot., datë 10.8.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2022”,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., me shkresën nr. 5506 prot., datë 4.8.2022, protokolluar në ERE me nr. 1441 prot., datë 8.8.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 31,28 lekë/kwh për muajin korrik 2022, ku janë përfshirë edhe kostot e disbalancave, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 5505 prot., datë 4.8.2022, protokolluar në ERE me nr.

1442 prot., datë 8.8.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike prej 18,34 lekësh/kwh për muajin korrik 2022, ku janë përfshirë edhe kostot e disbalancave, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20 kV, 10 kV, si dhe 6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF).

- Mbështetur në nenin 6, pika 3 dhe pika 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin nr. 201 të Bordit të ERE-s, datë 4.12.2017, të ndryshuar, tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e livrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori. Kostot e disbalancave do të llogariten dhe do të faturohen nga shoqëria, në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut të Balancimit dhe të akteve të tjera në fuqi.

- Në lidhje me komponentët e tjerë të përlllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF për muajin korrik 2022 evidentojmë, se, në përputhje me nenin 9 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2022 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët, që furnizohen nga FMF-ja për muajin korrik 2022, paraqiten në tabelën përmbledhëse, si vijon

:



Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për nivele tensioni për muajin Korrik 2022			
KORRIK 2022		Nivelet e tensionit	
		35 kV	20/10/6 kV
	Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	26.93
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.81
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh	31.20
			18.26

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikime rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2022 do të jetë:

- 31.20 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;

- 18.26 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

1.Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2022, prej:

- 31,20 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;

- 18,26 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 208, datë 17.8.2022

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 70, DATË 11.4.2022, “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 489, SERIA P21, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGIJËS ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË ‘GERTI’ SHPK”, DHE RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 99, DATË 16.4.2021, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘GERTI’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGIJËS ELEKTRIKE NGA HEC ‘VARDARI’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1972 kw”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 8, germa “a” dhe të nenit 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1458/4 prot., datë 12.8.2022, “Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 70, datë 11.4.2022, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 489, seria P21, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k.”, me vendimin e datës datë 16.4.2021 dhe rishikimin



e vendimit nr. 99, datë 16.4.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Vardari’, me kapacitet të instaluar 1972 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 70, datë 11.4.2022, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës së shoqërisë “Gerti” sh.p.k. nr. 489, seria P21, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari”, me kapacitet të instaluar 1972 kw.

- Vendimmarrja sa më sipër u mor në rrethanat e konstatimit të mosplotësimit të kushteve të vendosura në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021.

- Shoqëria është njoftuar për vendimin nr. 70, datë 11.4.2022, me shkresën nr. 67/5 prot., datë 20.4.2022, ku i është sjellë në vëmendje dhe e drejta për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k. është përgjigjur brenda afatit 30-ditor, duke paraqitur në ERE dokumentacion/informacion përkatës.

- Në lidhje me kushtin që ka të bëjë me depozitimin në ERE të kontratës së qirasë të lidhur midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe Bashkisë Librazhd, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik, ndërtim dhe shfrytëzim HEC-i Vardari”, me palën qiramarrëse të zëvendësuar, rezulton se mbetet ende pa plotësuar pavarësisht përpjekjes së shoqërisë. Në vijim vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të dokumentojë në ERE këtë transferim brenda 6 (gjashtë) muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

- Në lidhje me kushtin që ka të bëjë me depozitimin në ERE të Pasqyrave Financiare të vitit 2020 ku pasqyrohen asetet fikse të transferuara nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “Gerti” sh.p.k., brenda datës 30.6.2021, rezulton, se, në datën 14.6.2020, është nënshkruar kontrata përkatëse për kalimin e 100% të kuotave të “Drini Bulqizë” sh.p.k. te “Gerti” sh.p.k. Në vijim, shoqëria duhet të depozitojë në ERE çdo dokument që vërteton kalimin e pronësisë apo dhënien në përdorim të aseteve nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “Gerti” sh.p.k.

- Në lidhje me kushtin që ka të bëjë me përcjelljen në ERE të finalizimit të heqjes nga fondi pyjor kullësor të sipërfaqes së përcaktuar për

zhvillimin e projektit, jo më vonë se një muaj nga disponimi i tij, shoqëria ka depozituar në ERE urdhrin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 73, datë 13.3.2019, për heqjen nga fondi pyjor publik të zonës që do të përdoret si shesh ndërtimi për godinën e HEC “Vardari” dhe infrastrukturës ndihmëse nga shoqëria. Ky kusht rezulton i plotësuar nga shoqëria.

- Në nenin 9, germa “a” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, parashikohet se me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8 të kësaj Rregulloreje, Bordi do të vendosë, ndër të tjera: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.

- Në analizë të sa më sipër, konstatojmë se shkak ligjor për të cilin ERE vendosi për fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 489, seria P21, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021, ka rënë pjesërisht, ndaj në zbatim të përcaktimeve të Rregullores, vlerësohet mbyllja e procedurës së nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 70, datë 11.4.2022.

- Gjithashtu vlerësohet edhe rishikimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari” me kapacitet të instaluar 1972 kw”.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti administrativ, me nismën e vet organit, që ka kompetencë të nxjerrë aktin, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mbyllë procedurën administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 70, datë 11.4.2022, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 489, seria P21, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k.”.

2. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë



elektrike nga HEC ‘Vardari’, me kapacitet të instaluar 1972 kw”, bëhen këto ndryshime:

Pika 1 ndryshon si vijon:

1. Të licencojë shoqërinë “Gerti” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari”, me kapacitet të instaluar 1972 kw, për një afat 30-vjeçar.

Pika 2 ndryshon, si vijon:

2. Brenda 6 (gjashtë) muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi, shoqëria “Gerti” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE çdo dokument që vërteton kalimin e pronësisë apo dhënien në përdorim të aseteve nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “GERTT” sh.p.k.

3. Pika 3 shfuqizohet.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

5. Brenda 6 (gjashtë) muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi, shoqëria “Gerti” sh.p.k. duhet të dokumentojë në ERE transferimin e kontratës së qirasë “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik, ndërtim dhe shfrytëzim HEC-i Vardari”, të lidhur me Bashkinë Librazhd nga “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “GERTT” sh.p.k.

5. Pikat 5 dhe 6 bëhen përkatësisht pikat 6 dhe 7.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 209, datë 17.8.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 167, DATË 28.6.2022 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SALLARI ENERGY TRADE’ SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1458/1 prot., datë 11.8.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike” dhe “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 168, datë 28.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 167, datë 28.6.2022, vendosi të licencojë shoqërinë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar. Shoqëria kishte detyrimin që të informonte ERE-n çdo tre muaj, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në përfundim të këtij procesi.

- ERE, njoftoi shoqërinë për vendimin e mësipërm me shkresën nr. 469/8 prot., datë 30.6.2022.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 469/9 prot., datë 1.8.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, brenda afatit të përcaktuar.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të



pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka kompetencë të nxjerrë aktin, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 210, datë 17.8.2022

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 168, DATË 28.6.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SALILLARI ENERGY TRADE’ SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të

datës 17.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1458/1 prot., datë 11.8.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike” dhe “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 168, datë 28.6.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 168, datë 28.6.2022, vendosi të licencojë shoqërinë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar. Shoqëria kishte detyrimin që të informonte ERE-n çdo tre muaj, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në përfundim të këtij procesi.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 168/2022, me shkresën nr. 469/8 prot., datë 30.6.2022.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 469/9 prot., datë 1.8.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, brenda afatit të përcaktuar.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka në kompetencë të nxjerrë aktin, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 dhe pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 168, datë 28.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të



Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 211, datë 17.8.2022

MBI SHTYRJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s
PËR APLIKIMIN E SHOQËRISË
“EGNATIA HYDROPOWER” SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pikat 2 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1458/3 prot., datë 12.8.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 120, datë 24.5.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Gostima 1”, me kapacitet të instaluar 3047 kw; “Gostima 2”, me kapacitet të instaluar 5586 kw; “Gostima 3”, me kapacitet të

instaluar 5335 kw; “Gostima 4”, me kapacitet të instaluar 7396 kw; “Gostima 5”, me kapacitet të instaluar 10321 kw; “Gostima 5/1”, me kapacitet të instaluar 450 kw dhe “Gostima 6”, me kapacitet të instaluar 16819 kw, me kapacitet total të instaluar 48 864 kw.

- ERE ka bërë njoftimin në medien e shkruar për këtë vendimmarrje, i cili është botuar në datat 25.5.2022 dhe 26.5.2022 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve të mundshme nga të tretët (data 5.7.2022) nuk ka rezultuar të kishte të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 636/1 prot., datë 6.6.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin dhe kërkesën për plotësim dokumentacioni.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 636/5, datë 12.7.2022 dhe nr. 636/7 prot., datë 5.8.2022, ka përcjellë dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se mbetet ende pa u plotësuar sa vijon:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor neni 9, pika 2:

- gërma “g”, në lidhje me kërkesat e kësaj pike të rregullores, shoqëria ka depozituar kontratat përkatëse të qirasë për zonën ku do të zhvillohet projekti, ku afati i hyrjes në fuqi të secilës prej këtyre kontratave kushtëzohet nga marrja e lejes së ndërtimit. Gjithashtu, fillimi i punimeve të ndërtimit të veprës vlejnë dhe për të përlllogaritur afatin e vlefshmërisë së Deklaratës Mjedisore, datë 27.8.2020, lëshuar nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit, për personin juridik “Egnatia Hydropower” sh.p.k., për të zhvilluar projektin e zbatimit të HEC-eve “Kaskada Egnatia-Shushicë”. Sa më sipër, shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e ndërtimit dhe informacion mbi fillimin e punimeve.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- gërma “c”, shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion/informacion argumentues mbi strukturën dhe mënyrën e financimit të 40% të vlerës së investimit të projektit.

Dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1:

Në lidhje me kërkesat e rregullores, shoqëria duhet të plotësojë për secilin nga HEC-et të dhënat, në lidhje me kapacitetin ujëmbledhës,



nënstacionin ku lidhet, rendimentin dhe jetëgjatësinë e pritshme të centralit.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është parashikuar, se: “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.”.

- Shoqëria ka plotësuar pjesën më të madhe të dokumentacionit të kërkuar nga rregullorja, për këtë arsye vlerësohet shtyrja me 30 (tridhjetë) ditë pune e afatit të vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke i dhënë kështu mundësinë për të plotësuar dhe dokumentacionin/informacionin e mbetur të paplotësuar tërësisht.

- Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin/informacionin përkatës brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e vendimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e vendimit, shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE:

a) lejen e ndërtimit dhe informacion mbi fillimin e punimeve;

b) dokumentacion/informacion argumentues mbi strukturën dhe mënyrën e financimit të 40% të vlerës së investimit të projektit;

c) informacion mbi kapacitetin ujëmbledhës, nënstationin ku lidhet, rendimentin dhe jetëgjatësinë e pritshme të centralit, për secilin nga HEC-et, sipas përcaktimeve të nenit 9, pika 4.1.1.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 212, datë 17.8.2022

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 380, SERIA T17, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “ALIN TRADING” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 137, DATË 6.9.2017

Në mbështetje të nenit 16, nenit 17, pika 4 dhe nenit 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, germa “ç” dhe nenit 9, germa “c” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 3.6.4 dhe pikës 5.1, germa “ç” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1458/2 prot., datë 10.8.2022, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi heqjen e licencës nr. 380, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Alin Trading’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 6.9.2017”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 143, datë 6.6.2022, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 380, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 6.9.2017, për arsye se shoqëria nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2021 për licencën për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, e po ashtu nuk kishte depozituar në ERE asnjë dokument apo argument, në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 517/1 prot., datë 10.6.2022, ERE i ka njoftuar shoqërisë vendimmarrjen si më sipër, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi. Shkresa e dërguar



shoqërisë është kthyer mbrapsht nga posta, ndaj i është dërguar dhe me postë elektronike, e skanuar. Në këto rrethana, përveç sa më sipër, shoqëria nuk ka zbatuar dhe përcaktimet e pikës 3.6.4 të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, ku është parashikuar detyrimi i të licencuarve për të njoftuar ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të adresës.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 143, datë 6.6.2022, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022.

- Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar (afati i fundit data 6.8.2022), duke e përlogaritur këtë afat 30 ditë nga marrja dijeni nga Fletorja Zyrtare, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenin 5, germa “ç” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe pikën 5.1, germa “ç” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike”, parashikohet, se: “ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.”.

- Në nenin 9, germa “c”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, parashikohet, se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat, sipas nenet 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë, për: c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe / ose “d” të nenit 5 të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8 të kësaj Rregulloreje.

- Me heqjen e licencës nr. 380, seria T17, për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 6.9.2017, shoqëria “Alin Trading” sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 380, seria T17, për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 6.9.2017.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Alin Trading” sh.p.k. dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



KËRKESË
Nr. 51/6, datë 1.9.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën “Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Zgjerimi i varrezave publike Kuçovë””.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Kuçovë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik, “Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Zgjerimi i varrezave publike Kuçovë””.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët

preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Kuçovë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 2,374,693 (dy milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

DREJTOR I PËGJITHSHËM
KRYETAR
I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË
SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim



**LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË
CILËVE PREKEN NGA NDËRTIMIT I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE KUÇOVË”**

VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM														
PRONARI				TË DHËNAT KADASTRALE					TOKE ARË			Vlera e kulturave bujqësore dhe e drufrutorëve, sipas procesverbalit të Drejtorisë së Bujqësisë	VLERA	
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshat/qytet	Nr. i pas.	ZK	Lloji i pasurisë	Totale	Sipërf. e shpronës. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Vlera e drufrutoreve	Totali	Shënime
1	Fitim	Isa	Çela	Polovine	648/7	2179	Are	4000	4000	268	1072000	766 693	1,838,693	
2	Niko	Dervish	Luzi	Polovine	648/6	2179	Are	2000	2000	268	536 000		536 000	
TOTALI													2,374,693	

**KËRKESË****Nr. 90/6, datë 1.9.2022****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i segmentit rrugor ‘Sistemim-asfaltim rruga Korçë–Ersekë, loti 1’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë

3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “tokë arë” dhe “tokë truall”, si dhe bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi ose jobanimi”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 5 396 714 (pesë milionë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e katërmëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim



**LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘SISTEMIM ASFALTIM RRUGA KORÇË-ERSEKË, LOTI 1’”**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. pas	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale (m2)	Sip. shpronës. truall, arë	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek ¹)	Sip. Ndërtimi (m ²)	Vlera sipas preventivit (soc.- ekonomike) lek	VLERA TOTALE (lek)	Adresa	Shënime
1	Eduart Hysen Bejko, Stefanos Hysen Bejko			8564	7/1501	Ndërtesë 1-katëshe, punishte mermeri +truall	25	25	8537	213425	25	279247.8	492672.8	Korçë	Konfirmim ASHK
2	Viola	Kujtim	Shahinaj	8564	7/173	Truall	377.05	65	8537	554905			554905	Korçë	Konfirmim ASHK
3	Buratin	Xhemal	Beqiraj	8564	7/15	Truall	515	74	8537	631738			631738	Korçë	Konfirmim ASHK
4	BP Potka			8564	7/13	Truall	434.44	65	8537	554905			554905	Korçë	Konfirmim ASHK
5	Bardhyl Selim Selaj, Nertila Irjat Selaj			8564	7/12	Ndërtesë 1-katëshe, vend roje+truall	288	25	8537	213425	7.8	105992.9	319417.9	Korçë	Konfirmim ASHK (regj. kontratë hipotekare Banka Credins)
6	Bujar	Mehmet	Sula	8564	7/11	Truall	363.56	65	8537	554905			554905	Korçë	Regj. kontratë hipotekare “FAF” sh.a.
7	Kristaq	Foto	Gusho	2631	158/245	Arë	1463	127	100	12700			12700	Korçë	Konfirmim ASHK
8	Gezim	Selim	Selaj	2631	158/167	Truall	1000	102	1970	200940			200940	Korçë	Kufizim: Me shkresën nr. 8047 regj. Datë 11.09.2019 te Bashkise Korçe, vendoset barrë hipotekare
9	Vasil	Hekuran	Thanasi	2631	158/12	Arë	2680	77	100	7700			7700	Korçë	Konfirmim ASHK, kufizim: Me shkresën nr. 1781 regj., datë 29.9.2017 të Zyrës Përbarimore Korçe, administruar pranë ZVRPP-së me nr. 7389 prot., datë 5.10.2017, vendoset sekuestro konservative
10	Thodharaq		Pacili	2631	155/84	Arë	3350	781	100	78100			78100	Korçë	Konfirmim ASHK
11	Lavderim	Kajo	Kantollari	2631	155/82	Arë	2000	134	100	13400			13400	Korçë	Konfirmim ASHK
12	Enver	Myftar	Najto	2631	155/273	Arë	500	183	100	18300			18300	Korçë	Konfirmim ASHK
13	Vangjel	Myftar	Najte	2631	155/104	Arë	427	155	100	15500			15500	Korçë	Konfirmim ASHK
14	Selajdin	Shaqir	Braho	2631	155/153	Arë	1000	172	100	17200			17200	Korçë	Konfirmim ASHK
15	Kosta	Ramis	Sulenji	2631	155/99	Arë	1000	196	100	19600			19600	Korçë	Konfirmim ASHK
16	Hajrulla	Emin	Kokoshi	2631	155/73	Arë	2130	120	100	12000			12000	Korçë	Konfirmim ASHK
17	Janaq	Jorgaq	Tarusha	2631	155/72	Arë	2150	113	100	11300			11300	Korçë	Konfirmim ASHK
18	Thanas	Spiro	Tarusha	2631	155/71	Arë	2000	62	100	6200			6200	Korçë	Konfirmim ASHK
19	Anesti	Jorgji	Tori+bp.	2631	155/252	Arë	2070	53	100	5300			5300	Korçë	Konfirmim ASHK
20	Kostandin	Thodharaq	Tanushi	2631	155/172	Arë	197.6	73	100	7300			7300	Korçë	Konfirmim ASHK
21	Athina	Nevruz	Qyrani+bp.	2631	155/202	Truall	702,63	170	1970	334900			334900	Korçë	Konfirmim ASHK
22	Vasillaq	Stavri	Kota	2631	155/45	Arë	2060	53	100	5300			5300	Korçë	Konfirmim ASHK
23	Anila	Bexhet	Kamberi	2631	155/132	Arë	1000	78	100	7800			7800	Korçë	Konfirmim ASHK
24	Anesti	Vasil	Gonica	2631	155/39	Arë	1370	34	100	3400			3400	Korçë	Konfirmim ASHK
25	Mirela	Seit	Hyseni	2631	155/165	Arë	1040	82	100	8200			8200	Korçë	Konfirmim ASHK
26	Pavlina	Guri	Kotori	2631	155/37	Arë	1280	24	100	2400			2400	Korçë	Konfirmim ASHK
27	Hanife	Sami	Xurre+bp	2631	155/36	Arë	3500	74	100	7400			7400	Korçë	Konfirmim ASHK
28	Vasil	Thoma	Hroni	2631	155/140	Arë	250	39	100	3900			3900	Korçë	Konfirmim ASHK
29	Thanas	Vasil	Sidheri	2631	155/34	Arë	3250	70	100	7000			7000	Korçë	Konfirmim ASHK
30	Klodjan		Mersini	2631	155/33	Arë	1460	35	100	3500			3500	Korçë	Konfirmim ASHK



	Astrit		Mersini						0			0	Korçë	
31	Vasil	Hysen	Mborja	2631	155/32	Arë	4160	67	100	6700		6700	Korçë	Konfirmim ASHK
32	Vasil	Pano	Tori	2631	155/29	Arë	3690	85	100	8500		8500	Korçë	Konfirmim ASHK
33	Jorgji	Koço	Mihallari	2631	155/168	Truall	3002	172	1970	338840		338840	Korçë	Konfirmim ASHK, kufizim: Prona vënë në hipotekë për llogari të ProCredit Bank sh.a.
34	Pëllumb	Hajdër	Mysllinj	2631	155/24	Arë	3620	102	100	10200		10200	Korçë	Konfirmim ASHK
35	Ali Telha Beçka+BP.			2631	155/23	Arë	1120	37	100	3700		3700	Korçë	Konfirmim ASHK
36	Ylli	Izet	Mara+BP.	2631	155/22	Arë	750	22	100	2200		2200	Korçë	Konfirmim ASHK
37	Kostaq	Thanas	Tarusha	2631	155/181	Arë	1300	39	100	3900		3900	Korçë	Konfirmim ASHK
38	Kristo	Vasil	Zguri	2631	155/20	Arë	4130	178	100	17800		17800	Korçë	Konfirmim ASHK
39	Dhimiter	Aleks	Mihollari	2631	155/101	Truall	1500	135	1970	265950		265950	Korçë	Konfirmim ASHK
40	Shaban	Haxhi	Dervishi	2631	155/130	Arë	1400	46	100	4600		4600	Korçë	Konfirmim ASHK
41	Haxhi	Shaban	Dervishi	2631	155/131	Arë	2100	101	100	10100		10100	Korçë	Konfirmim ASHK
42	Ilia	Kostandin	Xega	2631	155/151	Arë	1400	77	100	7700		7700	Korçë	Konfirmim ASHK
43	Petrit	Avdurahman	Mema	2631	155/14	Arë	2800	120	100	12000		12000	Korçë	Konfirmim ASHK
44	Ali	Hymet	Tare	2631	155/13	Arë	2250	101	100	10100		10100	Korçë	Konfirmim ASHK
45	Pandeli	Koço	Zhidro	2631	155/11	Arë	2870	135	100	13500		13500	Korçë	Konfirmim ASHK
46	Vehbi	Pasho	Pasho	2631	155/10	Arë	2620	103	100	10300		10300	Korçë	Konfirmim ASHK
47	Zoi	Toli	Tarusha	2631	155/228	Arë	2570	89	100	8900		8900	Korçë	Konfirmim ASHK
48	Mihal	Andon	Gorica	2631	155/7	Arë	3370	147	100	14700		14700	Korçë	Konfirmim ASHK
49	Vasil	Spiro	Tarusha	2631	155/6	Arë	3250	166	100	16600		16600	Korçë	Konfirmim ASHK
50	BP Hali			2631	155/119	Truall	800	116	1970	228520		228520	Korçë	Konfirmim ASHK
51	Visar	Llambi	Juka	2631	155/4	Arë	2800	152	100	15200		15200	Korçë	Konfirmim ASHK
52	Demir	Osman	Pelo	2631	155/3	Arë	3250	190	100	19000		19000	Korçë	Konfirmim ASHK
53	Petrit	Muharem	Sala	2631	155/2	Arë	1850	77	100	7700		7700	Korçë	Konfirmim ASHK
54	Ardian	Engjëllush	Demçe	2631	155/315	Arë	3266.9	69	100	6900		6900	Korçë	Konfirmim ASHK
55	Arçile	Vangjel	Zharkalli	1631	18/1	Arë	3900	120	100	12000		12000	Korçë	Servitut kalimi TAP. VKM nr. 246, datë 30.3.2016
56	Sami	Isa	Ramolli	1631	18/2	Arë	5450	705	100	70500		70500	Korçë	Servitut kalimi TAP. VKM nr. 641, datë 7.9.2016
57	Qamil	Nebi	Hasankolli	1631	16/1	Arë	2044	139	100	13900		13900	Korçë	Konfirmim ASHK
58	Koço	Nasho	Xhavara	1631	12/9	Arë	2460	27	100	2700		2700	Korçë	Servitut kalimi TAP. VKM nr. 641, datë 7.9.2016
59	Panajot	Nasho	Xhavara	1631	12/8	Arë	4450	30	100	3000		3000	Korçë	Servitut kalimi TAP. VKM nr. 641, datë 7.9.2016
60	Naime	Hysen	Elezi	1631	12/5	Arë	2350	52	100	5200		5200	Korçë	Servitut kalimi
61	Fluturije	Refat	Elezi	1631	12/4	Arë	1850	36	100	3600		3600	Korçë	Servitut kalimi
62	Ferdinand	Sejamit	Elezi	1631	12/3	Arë	1700	29	100	2900		2900	Korçë	Servitut kalimi TAP. VKM nr. 641, datë 7.9.2016
63	Bardhyl	Sadik	Elezi	1631	12/2	Arë	3500	101	100	10100		10100	Korçë	Servitut kalimi TAP. VKM nr. 641, datë 7.9.2016
64	BP Elezi, Sulo, Molla, Gengo			1631	12/1	Arë	3000	92	100	9200		9200	Korçë	Servitut kalimi TAP. VKM nr. 527, datë 27.9.2017
65	Sulejman	Avdulla	Pelivani	1631	35/1	Arë	3700	138	100	13800		13800	Korçë	Servitut kalimi
66	Fluturije	Refat	Elezi	1631	35/2	Arë	700	59	100	5900		5900	Korçë	Servitut kalimi TAP. VKM nr. 641, datë 7.9.2016
67	Naime	Hysen	Elezi	1631	35/3	Arë	2100	56	100	5600		5600	Korçë	Servitut kalimi
68	Ismail	Muharem	Tankollari	1631	35/4	Arë	3587	76	100	7600		7600	Korçë	Servitut kalimi
69	Thoma	Jani	Mejdi	1631	35/5	Arë	2626	55	100	5500		5500	Korçë	Servitut kalimi TAP. VKM nr. 641, datë 7.9.2016
70	Hekuran	Fejzi	Bejkolli	1631	35/6	Arë	2842	52	100	5200		5200	Korçë	Servitut kalimi TAP. VKM nr. 246, datë



															30.3.2016
71	Demirali	Rakip	Shahinlli	1631	35/7	Arë	557	9.2	100	920			920	Korçë	
72	Jani	Demirali	Shahinlli	1631	35/8	Arë	2383	31	100	3100			3100	Korçë	Servitut kalimi TAP. VKM nr. 246, datë 30.3.2016
73	Hashi	Rakip	Shahinlli	1631	35/9	Arë	1097	22	100	2200			2200	Korçë	
74	Nuri	Sadik	Dalipi	1631	35/10	Arë	1670	27	100	2700			2700	Korçë	Servitut kalimi TAP. VKM nr. 246, datë 30.3.2016
75	Nevrus	Hajdar	Hasankolli	1631	35/11	Arë	4708	17	100	1700			1700	Korçë	Konfirmim ASHK
76	Xhoxhi	Ligor	Shengjergji	1631	70/1	Arë	6866	648	100	64800			64800	Korçë	Konfirmim ASHK
77	Agim	Ismahil	Shahinlli	1631	70/2	Arë	5604	18	100	1800			1800	Korçë	Konfirmim ASHK
78	Thodharaq	Nasho	Marko	1631	114/1	Arë	3670	51	100	5100			5100	Korçë	Konfirmim ASHK
79	Qerim	Bajram	Bekolli	1631	142/2	Arë	2500	209	100	20900			20900	Korçë	Konfirmim ASHK
80	Hekuran	Bajram	Bekolli	1631	142/4	Arë	3000	144	100	14400			14400	Korçë	Konfirmim ASHK
81	Lavdi	Sulo	Elezi	1631	9/1	Arë	1450	166	100	16600			16600	Korçë	Konfirmim ASHK
82	Sevet	Zenel	Elezi	1631	9/2	Arë	150	38	100	3800			3800	Korçë	Konfirmim ASHK
83	Servet	Zenel	Elezi	1631	9/4	Arë	1450	59	100	5900			5900	Korçë	Konfirmim ASHK
84	Lavdi	Sulo	Elezi	1631	9/5	Arë	3800	38	100	3800			3800	Korçë	Konfirmim ASHK
85	Panajot	Nasho	Xhavara	1631	9/6	Arë	3700	40	100	4000			4000	Korçë	Konfirmim ASHK
86	Joraz	Miho	Kapurani	1631	137/3	Arë	3600	119	100	11900			11900	Korçë	Konfirmim ASHK
87	Jaraz	Miho	Kapurani	1631	137/5	Arë	3100	258	100	25800			25800	Korçë	Konfirmim ASHK
88	Ethem	Hamit	Metja	1631	137/10-T	Arë	3400	60	100	6000			6000	Korçë	Konfirmim ASHK
	Bashkim	Hamit	Metja												
89	Lisaveta	Nevrus	Metja	1631	137/13	Arë	1000	129	100	12900			12900	Korçë	Konfirmim ASHK
	Luljeta	Hekuran	Veliija (Metja)												
90	Lisaveta	Nevrus	Metja	1631	280/6	Arë	2000	397	100	39700			39700	Korçë	Konfirmim ASHK
	Luljeta	Hekuran	Veliija (Metja)												
91	Jani	Asllan	Bekolli	1631	142/5	Arë	2454	105	100	10500			10500	Korçë	Konfirmim ASHK
92	Shtet			1631	18/4	Arë	5226	95	0	0			0	Korçë	Konfirmim ASHK
93	Shtet			1631	18/3	Arë	6250	186	0	0			0	Korçë	Okupuar nga Kosta Vasili
94	Shtet			1631	142/6	Arë	437	12	0	0			0	Korçë	Konfirmim ASHK
95	Shtet			1631	275/1	Arë	4750	180	0	0			0	Korçë	Konfirmim ASHK
96	Shtet			1631	137/9	Arë	2625	407	0	0			0	Korçë	Konfirmim ASHK
97	Shtet			1631	138	Arë	7625	394	0	0			0	Korçë	Konfirmim ASHK
98	Shtet			1631	140/2	Livadh	20300	2018	0	0			0	Korçë	Konfirmim ASHK
99	Shtet			1631	117/1	Arë	5250	608	0	0			0	Korçë	Okupuar nga Koli Kapurani
100	Shtet			1631	115/13	Arë	603	175	0	0			0	Korçë	Konfirmim ASHK
		SHUMA											5,396,714		



VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2022-3033 (1110), datë 19.7.2022, vendosi shpalljen të vdekur të shtetases Arsino Mersini më datë 1.5.1997.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë